



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.legjislacioni.gov.al

Nr. 65

Datë 12 maj 2014

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 243, datë 30.4.2014	Për largimin nga detyra të një anëtari të Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura.....	2439
Vendim i KM nr. 244, datë 30.4.2014	Për disa ndryshime në vendimin nr. 718, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve të personelit të hetimit, të inspektimit dhe të shërbimeve mbështetëse në Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme”, të ndryshuar.....	2439
Vendim i KM nr. 246, datë 30.4.2014	Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore.....	2440
Vendim i KM nr. 247, datë 30.4.2014	Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore.....	2444
Vendim i KM nr. 248, datë 30.4.2014	Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara.....	2448
Vendim i KM nr. 249, datë 30.4.2014	Për disa ndryshime në vendimin nr. 396, datë 31.3.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kufijve dhe rregullores së administrimit të parqeve arkeologjike të Shkodrës, Lezhës, Apolonisë, Bylisit, Amantias, Orikut, Antigonesë, Finiqit dhe Butrintit”, të ndryshuar.....	2450
Vendim i KM nr. 252, datë 30.4.2014	Për funksionimin, të drejtat dhe detyrat e Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë	2451
Udhëzim i MF nr. 13, datë 6.5.2014	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 32, datë 31.12.2013, “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”.....	2452
	Kërkesë për shpalljen të vdekur shtetasit Marjus Kasapi	2453

VENDIM
Nr. 243, datë 30.4.2014

PËR LARGIMIN NGA DETYRA TË NJË
ANËTARI TË KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT
ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË
UJËRAVE TË NDOTURA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 5 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Arjan Jovani, anëtar i Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, largohet nga kjo detyrë, për shkak të dorëheqjes.

2. Marrëdhëniet financiare t'i ndërpriten nga data 16.4.2014.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 244, datë 30.4.2014

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 718,
DATË 23.6.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË PERSONELIT
TË HETIMIT, TË INSPEKTIMIT DHE TË
SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE NË SHËRBIMIN E
KONTROLLIT TË BRENDSHËM, NË MINISTRINË
E BRENDSHME”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 51 të ligjit nr. 10 002, datë 6.10.2008, “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme”, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” dhe të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Punëve Brendshme, të ministrit të Financave dhe të ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 718, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Kudo në titull dhe në përmbajtjen e vendimit, emërtimi “Ministria e Brendshme” zëvendësohet me “Ministria e Punëve të Brendshme”.

b) Lidhja nr. 1, “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e personelit hetues të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm”, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtën numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi për politikën e reja të pagave për vitin 2014.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2014.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr. 1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR
PUNONJËSIT E PERSONELIT HETUES TË
SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Nr	Grada	Funksionet organike	Paga bazë për gradë	Shtesa për natyrë të veçantë pune
	1	2	3	4
1	Asistent	Ndihmësspecialist në provë në trupën operacionale	44500	9000
2	Agjent	Ndihmësspecialist në trupën operacionale	49000	9000
3	Agjent i I-rë	Drejtues grupi/ Ndihmës specialist në trupën operacionale	54500	9000
4	Hetues	Specialist hetimi në nivel vendor. Specialist hetimi në nivel vendor në provë	65000	8000
5	Hetues i I-rë	Specialist hetimi në nivel vendor	77000	8000
	Hetues i I-rë	Specialist hetimi në nivel qendror Shef seksioni në nivel qendror Shef sektori në nivel vendor	82000	10000
6	Drejtues	Shef seksioni në nivel qendror Shef sektori në nivel vendor Shef sektori në nivel qendror	88000	10000
7	Drejtues i I-rë	Shef sektori në nivel qendror Drejtor drejtorie në nivel vendor Drejtor drejtorie në nivel qendror	99000	10000
8	Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm	Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm (Drejtor i Departamentit të hetimit).	102000	15000
9	Drejtor i Përgjithshëm	Drejtor i Përgjithshëm	111000	20000

VENDIM
Nr. 246, datë 30.4.2014

**PËR PËRCAKTIMIN E NORMAVE TË CILËSISË
SË MJEDISIT PËR UJËRAT SIPËRFAQËSORE¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29 të ligjit nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Dispozita të përgjithshme

1. Qëllimi i këtij vendimi është vendosja e normave të cilësisë së mjedisit të trupave ujorë sipërfaqësore, për substancat prioritare dhe ndotës të tjerë, me qëllim arritjen e statusit të mirë kimik të ujërave sipërfaqësore dhe në përputhje me objektivat mjedisore, sipas nenit 25 të ligjit nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore".

2. Të gjithë termat e përdorur në këtë vendim kanë kuptimin që u është dhënë nga ligji nr. 111/2012, datë 15.12.2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore".

II. Normat e cilësisë së mjedisit

3. Për ujërat sipërfaqësore zbatohen normat e cilësisë së mjedisit, të përcaktuara në pjesën A të aneksit I, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Normat e cilësisë së mjedisit për trupat ujorë sipërfaqësorë zbatohen në përputhje me kërkesat e pjesës B të aneksit I bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Për kategori të caktuara të ujërave sipërfaqësore, si alternativë e normave të cilësisë së mjedisit të përmendura në pjesën A të aneksit I, mund të zbatohen normat e cilësisë së mjedisit për sedimentin dhe/ose biotën. Në raste të tilla:

a) Normat e cilësisë së mjedisit për indet e kafshëve të gjahut (peshë e njomë) zbatohen, duke zgjedhur atë indikator që është më i përshtatshëm për peshqit, molusqet, krustacet dhe llojet e tjera të biotës, si më poshtë vijon:

i) për merkurin dhe përbërësit e tij, 20 µg/kg;

ii) për heksaklorobenzenin, 10 µg/kg;

iii) për heksaklorobutadienin, 55 µg/kg.

b) Përveç normave të cilësisë së mjedisit të referuara në shkronjën "a", për sedimentin dhe/ose biotën, për substanca të tjera, të specifikuar sipas shkronjës "d", mund të përcaktohen dhe të zbatohen edhe norma të tjera të cilësisë së mjedisit. Normat e tjera duhet të ofrojnë, të paktën, të njëjtin nivel mbrojtjeje si ato që përcaktohen në pjesën A të aneksit I.

c) Agjencia Kombëtare e Mjedisit përcakton shpeshësinë e monitorimit të biotës dhe/ose sedimentit për substancat e referuara në shkronjat "a" dhe "b", të paktën, një herë në vit, në qoftë se, në bazë të gjykimit dhe njohurive teknike të saj, nuk justifikohet një shpeshësi tjetër monitorimi.

ç) Në planin e menaxhimit të basenit ujqor specifikohen substancat për të cilat do të përcaktohen normat e cilësisë së mjedisit, në përputhje me shkronjën "b", arsyet dhe bazat për përdorimin e kësaj përjasjeje, normat alternative të vendosura për cilësinë e mjedisit, përfshirë të dhënat dhe metodologjinë nga ku e kanë origjinën, kategoritë e ujërave sipërfaqësore ku zbatohen këto norma, shpeshësinë e planifikuar të monitorimit dhe justifikimin për atë shpeshësi.

III. Monitorimi dhe analiza

6. Agjencia Kombëtare e Mjedisit kryen analizën e tendencës afatgjatë për substancat prioritare të listuara në pjesën A të aneksit I, të cilat kanë tendencë të akumulohen në sediment dhe/ose në biotë, bazuar në monitorimin e statusit të ujërave, të kryer në përputhje me nenin 85 të ligjit nr. 111/2012, datë 15.12.2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore".

7. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në kryerjen e analizës së referuar në pikën 6, i kushton kujdes të veçantë substancave me numër 2, 5, 6, 7, 12, 15, 16, 17, 18, 20, 21, 26, 28 dhe 30, të përmendura në pjesën A të aneksit I, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

8. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në përputhje me objektivat mjedisore, të përcaktuar në nenin 25 të ligjit nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", merr masat e nevojshme për të siguruar që përqendrimet e substancave prioritare, të listuara në pjesën A të aneksit I, që i bashkëlidhet këtij vendimi, në sediment dhe/ose biotën përkatëse, të mos rriten shumë.

9. Agjencia Kombëtare e Mjedisit monitoron sedimentin dhe/ose biotën në mënyrë që të japë të dhëna të mjaftueshme për një analizë të besueshme të tendencës afatgjatë.

10. Agjencia Kombëtare e Mjedisit siguron që monitorimi i referuar në pikën 9 të kryhet të paktën çdo tre vjet, në qoftë se, në bazë të gjykimit dhe njohurive teknike të saj, nuk justifikohet një shpeshësi tjetër monitorimi.

IV. Inventari i emetimeve, shkarkimeve dhe humbjeve

11. Agjencia Kombëtare e Mjedisit harton inventarët, përfshirë hartat e emetimeve, shkarkimeve dhe humbjeve të të gjitha substancave prioritare dhe ndotësve të tjerë të listuar në pjesën A të aneksit I, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfshirë përqendrimet e tyre në sediment dhe biotë, sipas rastit, në qoftë se janë të disponueshme.

12. Inventarët e përmendur në pikën 11, hartohen për çdo basen ujor që shtrihet brenda Republikës së Shqipërisë.

¹ Direktiva 2008/105/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 16 dhjetor 2008, "Normat e cilësisë mjedisore në fushën e politikave të ujit", (OJ L 348, 24.12.2008, p. 84-970).

13. Inventarët e përmendur në pikën 11 hartohen në bazë të informacionit të grumbulluar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

14. Periudha e referencës për vlerësimin e vlerave të ndotësve, që duhen përfshirë në inventarët e përmendur në pikën 11, janë vitet 2012 dhe 2013.

15. Inventarët e përmendur në pikën 12 përditësohen, si pjesë e rishqyrtimit të analizës së karakteristikave të basenit ujqor përkatës, në përputhje me nenin 36 të ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”.

16. Periudha e referencës për përcaktimin e vlerave në inventarët e përditësuar, të përmendur në pikën 14, është viti përpara të cilit duhet të kryhet analiza.

17. Inventarët e përditësuar, të përmendur në pikën 15, përditësohen edhe në planin e menaxhimit të basenit ujqor përkatës.

18. Inventarët dhe të gjitha përditësimet e tyre, përfshirë periudhat përkatëse të referencës, vihen në dispozicion të publikut, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”.

19. Ministri miraton udhëzimet teknike për hartimin e inventarëve.

V. Ndotja ndërkuftare

20. Sipas rastit, në planin e menaxhimit të basenit ujqor për trupat ujqorë të ndikuar nga ndotja ndërkuftare specifikohet:

a) nëse normat e cilësisë së mjedisit janë tejkaluar, për shkak të një burimi ndotjeje jashtë juridiksionit të Republikës së Shqipërisë;

b) nëse si rezultat i një ndotjeje të tillë ndërkuftare, nuk mund të merren masa efektive për të respektuar normat përkatëse të cilësisë së mjedisit;

c) një përmbledhje e masave që janë ndërmarrë në lidhje me ndotjen ndërkuftare.

VI. Dispozita të fundit

21. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Këshilli Kombëtar i Ujqit dhe këshillat e baseneve ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Aneksi I. Normat e Cilësisë së Mjedisit të trupave ujore për substanca të caktuara

Pjesa A. Normat e Cilësisë së Mjedisit (EQN)

Për qëllime të kësaj table:

- MAC është Përqendrimi Maksimal i Lejueshëm
- AA është Mesatarja Vjetore
- Të gjitha vlerat janë në µg/L

Numri	Emri	Numri ⁽¹⁾ CAS	EQN ⁽²⁾ mesatare vjetore Ujërat ⁽³⁾ sipërfaqësorë të brendshme	EQN ⁽²⁾ mesatare vjetore Ujërat e tjerë sipërfaqësorë	MAC-EQN ⁽⁴⁾ Ujërat ⁽³⁾ sipërfaqësorë të brendshme	MAC-EQN ⁽⁴⁾ Ujërat e tjerë sipërfaqësorë
1	Alaklori	15972-60-8	0,3	0,3	0,7	0,7
2	Antraceni	120-12-7	0,1	0,1	0,4	0,4
3	Atrazina	1912-24-9	0,6	0,6	2,0	2,0
4	Benzeni	71-43-2	10	8	50	50
5	Difenileteri ⁽⁵⁾ i bromuar	32534-81-9	0,0005	0,0002	e pa aplikueshme	e pa aplikueshme
6	Kadmiumi dhe përbërjet e tij (në varësi të kategorive të fortësisë së ujit) ⁽⁶⁾	7440-43-9	≤ 0,08 (Kategoria 1)	0,2	≤ 0,45 (Kategoria 1)	≤ 0,45 (Kategoria 1)
			0,08 (Kategoria 2)		0,45 (Kategoria 2)	0,45 (Kategoria 2)
			0,09 (Kategoria 3)		0,6 (Kategoria 3)	0,6 (Kategoria 3)
			0,15 (Kategoria 4)		0,9 (Kategoria 4)	0,9 (Kategoria 4)
			0,25 (Kategoria 5)		1,5 (Kategoria 5)	1,5 (Kategoria 5)
6a	Tetraklorur karboni ⁽⁷⁾	56-23-5	12	12	e pa aplikueshme	e pa aplikueshme
7	C10-13 Kloroalkanet	85535-84-8	0,4	0,4	1,4	1,4
8	Klorfenvinfos	470-90-6	0,1	0,1	0,3	0,3
9	Klorpirifosi (Etil klorpirifosi)	2921-88-2	0,03	0,03	0,1	0,1
9a	Pesticide ciklodiene:		Σ = 0,01	Σ = 0,005	e pa aplikueshme	e pa aplikueshme
	Aldrini ⁽⁷⁾	309-00-2				
	Dieldrini ⁽⁷⁾	60-57-1				
	Endrini ⁽⁷⁾	72-20-8				
	Izodrini ⁽⁷⁾	465-73-6				
9b	DDT total ⁽⁷⁾⁽⁸⁾	e pa aplikueshme	0,025	0,025	e pa aplikueshme	e pa aplikueshme
	para-para-DDT ⁽⁷⁾	50-29-3	0,01	0,01	e pa aplikueshme	e pa aplikueshme
10	1,2-Dikloroetani	107-06-2	10	10	e pa aplikueshme	e pa aplikueshme
11	Diklorometani	75-09-2	20	20	e pa aplikueshme	e pa aplikueshme
12	Di(2-etileksil)-ftalat (DEHP)	117-81-7	1,3	1,3	e pa aplikueshme	e pa aplikueshme
13	Diuroni	330-54-1	0,2	0,2	1,8	1,8
14	Endosulfani	115-29-7	0,005	0,0005	0,01	0,004
15	Fluoroanteni	206-44-0	0,1	0,1	1,0	1,0
16	Hekzakloro-benzeni	118-74-1	0,01 ⁽⁹⁾	0,01 ⁽⁹⁾	0,05	0,05
17	Hekzakloro-butadieni	87-68-3	0,1 ⁽⁹⁾	0,1 ⁽⁹⁾	0,6	0,6
18	Hekzakloro- cikloheksani	608-73-1	0,02	0,002	0,04	0,02
19	Izoproturoni	34123-59-6	0,3	0,3	1,0	1,0
20	Plumbi dhe përbërjet e tij	7439-92-1	7,2	7,2	e pa aplikueshme	e pa aplikueshme
21	Mërkuri dhe përbërjet e tij	7439-97-6	0,05 ⁽⁹⁾	0,05 ⁽⁹⁾	0,07	0,07
22	Naftaleni	91-20-3	2,4	1,2	e pa aplikueshme	e pa aplikueshme
23	Nikeli dhe përbërjet e tij	7440-02-0	20	20	e pa aplikueshme	e pa aplikueshme
24	Nonilfenoli (4- Nonilfenoli)	104-40-5	0,3	0,3	2,0	2,0
25	Oktilfenoli ((4- (1,1',3,3'- tetrametilbutil)- fenoli))	140-66-9	0,1	0,01	e pa aplikueshme	e pa aplikueshme
26	Pentakloro-benzeni	608-93-5	0,007	0,0007	e pa aplikueshme	e pa aplikueshme
27	Pentakloro-fenoli	87-86-5	0,4	0,4	1,0	1,0
28	Hidrokarburet poliaromatike (HPA) ⁽¹⁰⁾	e pa aplikueshme	e pa aplikueshme	e pa aplikueshme	e pa aplikueshme	e pa aplikueshme
	Benzo(a)pireni	50-32-8	0,05	0,05	0,1	0,1
	Benzo(b)fluor-anteni	205-99-2	Σ = 0,03	Σ = 0,03	e pa aplikueshme	e pa aplikueshme
	Benzo(k)fluor-anteni	207-08-9				

Numri	Emri	Numri ⁽¹⁾ CAS	EQN ⁽²⁾ mesatare vjetore Ujërat ⁽³⁾ sipërfaqësore të brendshme	EQN ⁽²⁾ mesatare vjetore Ujërat e tjerë sipërfaqësore	MAC-EQN ⁽⁴⁾ Ujërat ⁽³⁾ sipërfaqësore të brendshme	MAC-EQN ⁽⁴⁾ Ujërat e tjerë sipërfaqësore
	Benzo(g,h,i)-perileni	191-24-2	$\Sigma = 0,002$	$\Sigma = 0,002$	e pa aplikueshme	e pa aplikueshme
	Indeno(1,2,3-cd)- pireni	193-39-5				
29	Simazina	122-34-9	1,0	1,0	4,0	4,0
29a	Tetrakloro-etileni ⁽⁷⁾	127-18-4	10	10	e pa aplikueshme	e pa aplikueshme
29b	Trikloro-etileni ⁽⁷⁾	79-01-6	10	10	e pa aplikueshme	e pa aplikueshme
30	Përbërjet e tributiltinës (Tributiltin-kimi)	36643-28-4	0,0002	0,0002	0,0015	0,0015
31	Trikloro-benzenet	12002-48-1	0,4	0,4	e pa aplikueshme	e pa aplikueshme
32	Trikloro-metani	67-66-3	2,5	2,5	e pa aplikueshme	e pa aplikueshme
33	Trifluralina	1582-09-8	0,03	0,03	e pa aplikueshme	e pa aplikueshme

Shënime për tabelën

(1) CAS: Shërbimi Kimik Abstrakt

(2) Ky parametër është EQN e shprehur si vlerë mesatare vjetore (EQN-AA). Në qoftë se nuk specifikohet ndryshe, ajo aplikohet në përqendrimin total të të gjitha izomereve.

(3) Ujërat sipërfaqësore të brendshme përfshijnë lumenjtë, liqenet dhe trupat artificiale apo tepër të modifikuar.

(4) Ky parametër është EQN, i shprehur si përqendrimi maksimal i lejueshëm (MAC-EQN). Në rastet kur për MAC-EQN është bërë shënimi “e paaplikueshme”, vlerat EQN-AA konsiderohen mbrojtëse ndaj pikut të ndotjes afatshkurtër për shkarkimet e vazhdueshme, meqë ato janë konsiderueshëm më të ulëta sesa vlerat që rrjedhin në bazë të toksicitetit akut.

(5) Për grupin e substancave prioritare të mbuluara nga difeniletet e bromuara (nr. 5) të përcaktuara në legjislacionin përkatës, përcaktohet një EQN vetëm për elementet e të njëjtit grup për numrat 28, 47, 99, 100, 153 dhe 154.

(6) Për kadmiumin dhe përbërjet e tij (nr. 6) vlerat e EQN ndryshojnë në varësi të fortësisë së ujit siç specifikohet në pesë kategoritë (Kategoria I: < 40 mg CaCO₃/l, kategoria 2: 40 deri në < 50 mg CaCO₃/l, kategoria 3: 50 deri në < 100 mg CaCO₃/l, kategoria 4: 100 deri në < 200 mg CaCO₃/l dhe kategoria 5: 200 mg CaCO₃/l).

(7) Kjo substancë nuk është substancë prioritare.

(8) DDT total përbëhet nga shuma e izomereve 1, 1, 1-trikloro-2,2 bis (p-klorofenil) etani (numri CAS 50-29-3; numri EU 200-024-3); 1,1,1-trikloro-2(0-klorofenil)-2-(p-klorofenil) etani (numri CAS 789-02-6; numri EU 212-332-5); 1,1-dikloro-2,2 bis (p-klorofenil) etileni (numri CAS 72-55-9; numri EU 200-784-6); dhe 1,1-dikloro-2,2 bis (p-klorofenil) etani (numri CAS 72-54-8; numri EU 200-783-0).

(9) Nëse nuk zbatohet EQN-në për biotën, duhet të prezantohet EQN-ja më strikte për ujin me qëllim që të

arrihet i njëjti nivel mbrojtjeje si me EQN-në për biotën që përcaktohet në paragrafin 5 të këtij vendimi. Plani i Menaxhimit të Rrethit të Basenit Lumor përcakton arsyet dhe bazat për përdorimin e kësaj përfaqëjeje, EQN-në alternative të përcaktuar për ujin, përfshirë të dhënat dhe metodologjinë prej së cilës është nxjerrë EQN alternative, dhe kategoritë e ujërave sipërfaqësore ku ajo zbatohet. Ky vendim amendohet, në mënyrë që të përcaktojë EQN-në alternative dhe kategoritë e ujërave ku zbatohet.

(10) Për grupin e substancave prioritare të hidrokarbureve poliaromatike (HPA) (nr. 28), është e aplikueshme çdo EQN individuale, d.m.th. EQN për Benzo(a) pirenin, EQN për shumën e Benzo(b)fluorantenit dhe Benzo(k)fluorantenit dhe EQN për shumën e Benzo(g,h,i)perilenit dhe Indeno(1,2,3-cd)pirenit.

Pjesa B. Zbatimi i normave të cilësisë së mjedisit të përcaktuara në pjesën A

1. Kolonat 4 dhe 5 të tabelës: Për çdo trup me ujëra sipërfaqësore, zbatimi i EQN-AA do të thotë që, për çdo pikë monitorimi përfaqësuese në atë trup ujqor, mesatarja aritmetike e përqendrimeve të matura në kohë të ndryshme gjatë një viti nuk e tejkalon normën.

Llogaritja e mesatares aritmetike, metoda analitike e përdorur dhe, në rastet kur nuk ka metodë analitike të përshtatshme që plotëson kriteret minimale të performancës, metoda e zbatimit të EQN-së duhet të jetë në përputhje me legjislacionin që miraton specifikimet teknike për monitorimin kimik dhe cilësinë e rezultateve analitike, në përputhje me ligjin "Për menaxhimin e integruar të ujërave".

2. Kolonat 6 dhe 7 të tabelës: Për çdo trup me ujëra sipërfaqësore, zbatimi i MAC-EQN do të thotë se përqendrimi i matur në cilëndo pikë monitorimi përfaqësuese brenda trupit ujqor nuk e tejkalon normën.

3. Me përjashtim të kadmiumit, plumbit, merkurit dhe nikelit (këtej e tutje “metalet”) EQN-të e përcaktuara në këtë aneks janë të shprehura si përqendrime totale në të gjithë kampionin e ujit. Në

rastin e metaleve EQN i referohet përqendrimit të holluar, d.m.th. fazës së holluar të një kampioni uji të përfuar nga filtrimi me anë të një filtri 0,45 µm apo çdo paratrajtimi të barazvlefshëm.

4. Ministria kur vlerëson rezultatet e monitorimit në lidhje me EQN-në, mund të marrë në konsideratë:

a) përqendrimit natyrale të metaleve dhe përbërjeve të tyre, në qoftë se ato pengojnë respektimin e vlerave EQN; dhe

b) fortësinë, pH apo parametrat e tjerë të cilësisë së ujit që ndikojnë bio-disponueshmerinë e metaleve.

VENDIM

Nr. 247, datë 30.4.2014

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE, TË KËRKESAVE E TË PROCEDURAVE PËR INFORMIMIN DHE PËRFSHIRJEN E PUBLIKUT NË VENDIMMARRJEN MJEDISORE²

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5 të nenit 17 të ligjit nr. 10 440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut gjatë vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM).

2. Për qëllim të këtij vendimi, do të zbatohen përkufizimet përkatëse të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, dhe ligjit nr. 10 440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis".

KREU I

INFORMIMI I PUBLIKUT GJATË PROCEDURËS PARAPRAKE TË VNM-SË

1. Procesi i informimit dhe i përfshirjes së publikut gjatë procedurës paraprake të VNM-së përfshin këto faza:

a) Informimin dhe marrjen e mendimit të publikut nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) për projektin, shoqëruar me sqarimet për procedurën në zbatim;

b) Shpalljen dhe publikimin e vendimit të AKM-së në faqen e saj të internetit.

2. AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së aplikimit për procedurën paraprake të VNM-së, publikon në faqen e saj të internetit, për 20 (njëzet) ditë rresht, informacionin e plotë për projektin, siç është paraqitur nga zhvilluesi.

²Ky vendim transpozon pjesërisht direktivën 85/337/KEE, datë 27.6.1985, "Mbi vlerësimin e efekteve të projekteve publike dhe private mbi mjedisin", të ndryshuar, numri CELEX: 31985L0337, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr.175, datë 5.7.1985, faqe 40-48.

3. Në publikimin e saj, AKM-ja sqaron:

a) procedurën që do zbatohet dhe afatin e parashikuar të marrjes së vendimit e të publikimit të tij në faqen e saj të internetit;

b) mënyrën dhe afatin kohor (20 ditë) të dhënies së mendimeve të publikut përpara marrjes së vendimit;

c) mënyrën dhe afatin e ankimimit ndaj vendimit.

4. Në përfundim të procedurës paraprake të VNM-së, vendimi i AKM-së publikohet i plotë në faqen e saj të internetit, ku publiku dhe palët e tjera të interesuara sigurojnë një kopje të plotë të tij.

KREU II

INFORMIMI, KONSULTIMI DHE DËGJESA PUBLIKE GJATË PROCEDURËS SË THELLUAR TË VNM-SË

1. Informimi dhe përfshirja e publikut gjatë procedurës së thelluar të VNM-së përfshin këto faza:

a) Informimin e publikut për projektin e propozuar dhe marrjen e mendimit të tij në fazën e përcaktimit të çështjeve që do të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së, shoqëruar me sqarimet për procedurën në zbatim;

b) Informimin e publikut për komunikimin që AKM-ja bën me zhvilluesin për çështjet që duhet të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së;

c) Informimin, ndërgjegjësimin dhe konsultimin e publikut nga ana e zhvilluesit gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së;

ç) Informimin dhe përfshirjen e publikut për organizimin dhe realizimin e dëgjësës publike;

d) Informimin e publikut dhe marrjen e mendimit të tij nga AKM-ja në fazën e shqyrtimit dhe miratimit të Deklaratës Mjedisore;

dh) Informimin e publikut gjatë monitorimit të ndikimeve në mjedis të projektit.

2. Informimi i publikut për projektin e propozuar dhe marrja e mendimit të tij në fazën e përcaktimit të çështjeve që do të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së

2.1 Për të bërë të mundur informimin dhe marrjen e mendimit nga publiku dhe OJF-të, AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës nga zhvilluesi, publikon në faqen e saj të internetit, për 20 (njëzet) ditë rresht, informacionin e plotë të paraqitur nga zhvilluesi. Në publikim AKM-ja sqaron:

a) procedurën që do të zbatohet për informimin, konsultimin dhe dëgjësën publike për projektin deri në miratimin e Deklaratës Mjedisore;

b) mënyrën dhe afatin kohor (20 ditë), duke sqaruar që brenda këtij afati mund të jepen mendime për çështjet, që duan të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së;

c) afatin e parashikuar për miratimin e Deklaratës Mjedisore dhe publikimit të saj në faqen e saj të internetit;

c) mënyrën dhe afatin e ankimit ndaj procedurës së pjesëmarrjes së publikut dhe Deklaratës Mjedisore.

2.2 Publiku dhe OJF-të japin mendimin e tyre brenda afatit të përcaktuar në pikën 2.1 të këtij kreu.

2.3 Në rast se projekti i propozuar ka karakter kombëtar, AKM-ja, në komunikimin që bën me zhvilluesin, lidhur me kërkesat për raportin e thelluar të VNM-së, i thekson atij nevojën e informimit dhe përfshirjes së publikut, duke përfshirë të gjitha njësitë administrative vendore që ndikohen nga projekti.

2.4 AKM-ja publikon menjëherë në faqen e saj të internetit komunikimin me zhvilluesin për çështjet që duhet të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së, ku përfshihen edhe mendimet e kërkesat e dhëna nga publiku.

3. Informimi, ndërgjegjësimi dhe konsultimi i publikut nga ana e zhvilluesit gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së

3.1 Me qëllim ndërgjegjësimin e publikut për ndikimet e mundshme të projektit në mjedis, zhvilluesi, gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së, informon dhe konsultohet në mënyrë të pavarur me publikun për këto ndikime, duke kryer:

a) publikimin e informacionit të plotë për projektin që është paraqitur në AKM, ekspozimin e informacionit që disponon për projektin në një zyrë të posaçme në zonën ku propozohet projekti ose në zyrën e njësisë së qeverisjes vendore (NJQV) përkatëse;

b) anketimin direkt të publikut të qendrave të banuara në zonën e ndikimit të mundshëm të projektit në mjedis;

c) gjatë publikimit dhe anketimit, sqarimin nga zhvilluesi të qëllimit dhe përcaktimit të mënyrës së kontaktit se ku mund të dërgohen mendimet (adresën postare, numrin e telefonit dhe postën elektronike).

3.2 Mendimet dhe kërkesat e dhëna nga publikut merren në konsideratë gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së.

3.3 Zhvilluesi dokumenton materialet e përdorura dhe evidencat përkatëse të procesit të informimit dhe konsultimit me publikun, duke i ruajtur dhe paraqitur ato si pjesë e dokumentacionit të aplikimit për Deklaratën Mjedisore.

4. Procedura e organizimit dhe kryerjes së dëgjësës publike dhe përgjegjësitë e zhvilluesit, AKM-së, ARM-së, NJQV-së për organizimin e dëgjësës

4.1 Zhvilluesi ka këto përgjegjësi:

a) Njofton AKM-në për dëgjësën publike, duke i dërguar programin për organizimin e saj, raportin e thelluar të VNM-së dhe përmbledhjen joteknike të tij;

b) Realizon njoftimin e publikut për organizimin e dëgjësës publike;

c) I dërgon NJQV-së dhe ARM-së nga 30 copë kopje të printuara të raportit të VNM-së dhe të përmbledhjes

joteknike të tij, të cilat i vihen në dispozicion publikut të interesuar;

c) Siguron mjediset ku do të mbahet dëgjësja me publikun;

d) Siguron pjesëmarrjen e ekspertit/ekspertëve, që kanë hartuar raportin e thelluar të VNM-së, ditën që organizohet dëgjësja publike;

dh) Merr në konsideratë mendimet dhe kërkesat e dhëna nga publiku ditën e dëgjësës dhe i pasqyron ato në raportin e thelluar të VNM-së ose argumenton arsyet e pamundësisë së marrjes në konsideratë.

4.2 AKM-ja ka këto përgjegjësi:

a) Pas njoftimit nga zhvilluesi, udhëzon ARM-në përkatëse për rolin e saj në realizimin e dëgjësës publike;

b) Publikon në faqen e saj të internetit njoftimin për organizimin e dëgjësës publike;

c) I dërgon zyrtarisht një kopje të njoftimit strukturës përkatëse për komunikimin me publikun në ministri;

c) Bashkëpunon me zhvilluesin duke i ofruar adresa e kontakte të OJF-ve dhe palëve që mund të kenë interes për dëgjësën publike;

d) Merr mendimin e publikut në fazën e shqyrtimit të projektit për Deklaratën Mjedisore;

dh) Merr në konsideratë rezultatet dhe kërkesat e publikut gjatë shqyrtimit për Deklaratën Mjedisore dhe procesit të VNM-së;

e) Publikon në faqen e saj të internetit informacionin që disponon për pjesëmarrjen e publikut gjatë procesit të VNM-së për projektin.

4.3 ARM-ja ka këto përgjegjësi:

a) Bashkëpunon me zhvilluesin dhe NJQV-në për organizimin e dëgjësës publike;

b) Afishon në ambientet e saj të punës dhe publikon në faqen e saj të internetit njoftimin përkatës për dëgjësën publike;

c) Ekspozon në ambientet e saj të punës kopjet e përmbledhjes joteknike të raportit të VNM-së;

c) Merr pjesë ditën e dëgjësës dhe mban shënim diskutimet e bëra nga të pranishmit;

d) I dërgon AKM-së raportin për diskutimet e bëra gjatë dëgjësës publike brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dëgjësja publike;

dh) Bashkëpunon me zhvilluesin duke i ofruar adresa e kontakte që disponon të OJF-ve dhe palëve që mund të kenë interes për dëgjësën.

4.4 Njësia e qeverisjes vendore ka këto përgjegjësi:

a) Publikon në ambientet dhe faqen e saj elektronike njoftimin përkatës për dëgjësën publike;

b) Ekspozon pranë zyrave të saj kopjet e përmbledhjes joteknike të raportit të VNM-së;

c) Bashkëpunon me zhvilluesin, duke i ofruar adresa e kontakte që disponon të OJF-ve dhe palëve që mund të kenë interes për dëgjësën publike;

c) Nxit përfshirjen e komunitetit në pjesëmarrjen për dëgjesën publike;

d) Merr pjesë në ditën e zhvillimit të dëgjesës publike.

5. Bashkëndimi paraprak për organizimin e dëgjesës publike

5.1 Zhvilluesi, mbasi ka hartuar raportin e thelluar të VNM-së, njofton AKM-në për organizimin e dëgjesës, duke i dërguar:

a) planin e punës për organizimin e dëgjesës;

b) informacionin për konsultimet e kryera gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së;

c) kopjen e njoftimit të hartuar sipas shtojcës I, bashkëlidhur këtij vendimi;

ç) kopjen elektronike të përmbledhjes joteknike të raportit të thelluar të VNM-së.

5.2 AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit, udhëzon ARM-në përkatëse të bashkëpunojë me NJQV-në dhe me zhvilluesin e projektit për realizimin e dëgjesës publike, duke i dërguar informacionin e paraqitur nga zhvilluesi sipas pikës 5.1.

5.3 ARM-ja, brenda 3 (tri) ditëve nga data e marrjes së njoftimit prej AKM-së, komunikon me NJQV-në në zonën ku propozohet projekti, duke i dërguar një kopje të plotë të informacionit që ka marrë prej AKM-së, si dhe e informon për përgjegjësinë që ka në:

a) publikimin dhe afishimin e njoftimit për dëgjesën publike;

b) ekspozimin e përmbledhjes joteknike të raportit të thelluar të VNM-së, pranë zyrave të NJQV-së;

c) garantimin e pjesëmarrjes së stafit përkatës të NJQV-së në dëgjesën publike;

ç) nxitjen e komunitetit për pjesëmarrje në dëgjesën publike.

5.4 AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit, i dërgon strukturës përkatëse për komunikimin me publikun në ministri një kopje të plotë të tij, e cila e publikon në rrjetet e mundshme të informimit.

5.5 Zhvilluesi, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e njoftimit që i bën AKM-së sipas pikës 5.1, dërgon në NJQV të paktën 100 kopje të shtypura të përmbledhjes joteknike të raportit të VNM-së.

5.6 Nëse zhvilluesi i projektit, mbasi ka njoftuar AKM-në, tërhiqet nga organizimi i seancës dëgjimore, atëherë ai informon menjëherë AKM-në dhe NJQV-në, por jo më vonë se 20 (njëzet) ditë nga data që ka njoftuar AKM-në sipas pikës 5.1.

5.7 Nëse AKM-ja njoftohet nga zhvilluesi, sipas pikës 5.6, atëherë ajo informon ARM-në për ndërprerjen e procesit të organizimit të dëgjesës publike.

5.8 Nëse zhvilluesi rifillon procedurën e organizimit të dëgjesës publike, atëherë procesi dhe afatet e parashikuara sipas këtij vendimi fillojnë nga e para.

6. Informimi i publikut për dëgjesën publike

6.1 Zhvilluesi i projektit, paralel me njoftimin e AKM-së, realizon, me shpenzimet e veta, informimin për zhvillimin e seancës dëgjimore. Informimi zgjat 20 (njëzet) ditë rresht dhe përfshin:

a) publikimin e njoftimit, me informacionin që kërkohet sipas shtojcës I, në median audiovizive e median e shkruar lokale dhe, në rast se projekti ka karakter kombëtar, edhe në median kombëtare;

b) vendosjen e një table informuese në vendin ku do të zhvillohet projekti, ku njoftimi për dëgjesën publike afishohet për 20 (njëzet) ditë rresht në mënyrë dhe vend të dukshëm;

c) ekspozimin e materialeve të dëgjesës në zyrat e NJQV-së përkatëse.

6.2 AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e njoftimit që merr nga zhvilluesi sipas pikës 5.1, kryen këto veprime:

a) Publikon në faqen e saj elektronike njoftimin dhe përmbledhjen joteknike të raportit të thelluar të VNM-së;

b) Afishon në hapësirën e informimit të publikut një kopje të njoftimit për dëgjesën publike.

6.3 ARM-ja, brenda 3 (tri) ditëve nga data e njoftimit të AKM-së, sipas pikës 5.2, kryen këto veprime:

a) Publikon në faqen e saj elektronike njoftimin dhe përmbledhjen joteknike të raportit të thelluar të VNM-së;

b) Afishon në zyrën e informimit të publikut një kopje të njoftimit për dëgjesën publike;

c) Ekspozon në zyrën e saj kopje të shtypura të raportit të thelluar të VNM-së dhe të përmbledhjeve joteknike të tij.

6.4 NJQV-ja, brenda 3 (tri) ditëve nga data e njoftimit të ARM-së, sipas pikës 5.3, kryen këto veprime:

a) Afishon në mjediset e saj, deri në datën e mbajtjes së seancës dëgjimore, njoftimin për dëgjesën publike;

b) Publikon në faqen e saj elektronike njoftimin dhe përmbledhjen joteknike të raportit të thelluar të VNM-së;

c) Ekspozon në zyrën e saj kopje të shtypura të raportit të thelluar të VNM-së dhe të përmbledhjeve joteknike të tij.

6.5 Publiku dhe palët e interesuara mund të japin mendimet e tyre në formë elektronike apo me shkrim deri ditën e organizimit të dëgjesës publike. Mendimet duhet të dërgohen në kontaktet e adresat e përcaktuara nga AKM-ja në njoftimin përkatës.

6.6 Mendimet e dhëna nga publiku, vetëm pranë AKM-së, i dërgohen nga AKM-ja të plota zhvilluesit të projektit, jo më vonë se 4 (katër) ditë nga data e mbajtjes së dëgjesës publike.

7. Zhvillimi i seancës dëgjimore

7.1 Seanca dëgjimore me publikun organizohet në një vend të përshtatshëm, sa më pranë vendndodhjes së projektit dhe jo më herët se dita e 30-të kalendarike nga data e njoftimit të AKM-së prej zhvilluesit, sipas pikës 5.1.

7.2 Ditën e zhvillimit të seancës dëgjimore janë të pranishëm:

- a) zhvilluesi i projektit me ekspertin/ekspertët që kanë hartuar raportin e thelluar të VNM-së;
- b) përfaqësuesi i ARM-së në qark/AKM-së;
- c) përfaqësues të NJQV-së së zonës ku propozohet projekti;
- ç) përfaqësues dhe palë të tjera të interesuara.

7.3 Përfaqësuesit e zhvilluesit prezantojnë rezultatet e raportit të thelluar të VNM-së për projektin, duke mbajtur shënim edhe mendimet dhe kërkesat e dhëna nga publiku.

7.4 Publiku dhe palët e tjera të interesuara shprehin mendimet e tyre për rezultatet e raportit të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

7.5 Përfaqësuesit e ARM-së mbajnë shënim në mënyrë të pavarur diskutimet e plota të seancës dëgjimore dhe i pasqyrojnë ato në një raport të posaçëm, që i dërgohet AKM-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e mbajtjes së seancës dëgjimore.

7.6 Raporti i dërguar në AKM nga ARM-ja publikohet menjëherë në faqen e internetit të AKM-së.

8. Informimi dhe tërheqja e mendimit të publikut gjatë shqyrtimit për Deklaratën Mjedisore

8.1 AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve mbas marrjes së aplikimit për Deklaratën Mjedisore, publikon në faqen e saj të internetit njoftimin, ku sqaron:

- a) se projekti ka hyrë në fazën e shqyrtimit përfundimtar për lëshimin e Deklaratës Mjedisore;
- b) se publiku dhe palët e interesuara gjatë 20 (njëzet) ditëve mund të shprehin mendime për ndikimet në mjedis të projektit;
- c) postën dhe adresën elektronike të AKM-së, ku mund të dërgohen mendimet;
- ç) se çdo koment, informacion, analizë apo mendim i paraqitur nga publiku vlerësohet i vlefshëm gjatë hartimit të Deklaratës Mjedisore dhe argumenton arsyet kur nuk janë marrë parasysh.

8.2 Deklarata Mjedisore publikohet menjëherë në faqen e internetit të AKM-së, ku publiku dhe palët e interesuara mund të sigurojnë një kopje të plotë të saj.

KREU III

INFORMIMI GJATË MONITORIMIT, ANKIMIMIT DHE DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

1. Pjesëmarrja e publikut në procesin e monitorimit të ndikimeve në mjedis të projektit

1.1 Zhvilluesi monitoron ndikimet në mjedis të projektit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në Deklaratën Mjedisore dhe të dhënat ia dërgon AKM-së, ARM-së dhe NJQV-së;

1.2 AKM-ja, ARM-ja dhe NJQV-ja i publikojnë menjëherë të dhënat e monitorimit të dërguara nga zhvilluesi i projektit në faqen e tyre të internetit;

1.3 Me kërkesë nga palët e interesuara, ARM-ja dhe AKM-ja u sigurojnë kopje të shtypura të të dhënave të monitorimit të paraqitura nga zhvilluesi;

1.4 Publiku mund të dërgojë mendime dhe komente për të dhënat e monitorimit pranë AKM-së dhe ARM-së.

2. Ankimimi dhe dispozita përfundimtare

2.1 Çdo palë e interesuar ka të drejtë të ankohet ndaj akteve, veprimeve apo mosveprimeve gjatë zhvillimit të procedurës së informimit dhe pjesëmarrjes së publikut në procesin paraprak dhe të thelluar të VNM-së, në zbatim të legjislacionit në fuqi. Ankimi i drejtohet ministrit.

2.2 Për përmbushjen e afateve kohore të kësaj procedure, institucionet me rol e përgjegjësi në këtë procedurë shkëmbejnë informacionin nëpërmjet komunikimit elektronik, në përputhje me përcaktimet në legjislacionin përkatës në fuqi.

2.3 Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, kreu IV i vendimit nr. 994, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave, "Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje", shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, agjencitë rajonale të mjedisit dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

SHTOJCA I

Njoftimi për organizimin e dëgjësës publike përfshin informacionet e mëposhtme:

- a) Emrin dhe adresën e zhvilluesit;
- b) Qëllimin dhe vendndodhjen e veprimtarisë së propozuar;

c) Faktin që AKM-ja është njoftuar për zhvillimin e dëgjësës publike;

ç) Faktin që kopje të raportit të thelluar të VNM-së gjenden pranë zyrave të ARM-së dhe NJQV-së përkatëse dhe kopje të përmbledhjeve joteknike të raportit të thelluar të VNM-së do të publikohen në faqen elektronike të AKM-së, ARM-së, NJQV-së;

d) Faktin që materialet e dëgjësës publike do të ekspozohen në zyrat e tyre;

dh) Adresat ku mund të kryhet, inspektimi/konsultimi i këtyre dokumenteve, pranë vendndodhjes së projektit, ARM-së apo NJQV-së;

e) Faktin që çdo person mund të japë mendime e të bëjë komente për projektin e propozuar, afatin e fundit deri kur këto dokumente do të jenë në dispozicion të publikut dhe brenda të cilit mund të jepet mendim (jo më pak se 20 ditë nga data e shpalljes së njoftimit);

ë) Personin përgjegjës, të caktuar nga zhvilluesi i projektit, dhe kontaktet përkatëse ku mund të dërgohen mendimet e komentet e publikut;

f) Kontaktet e AKM-së, ku palët e interesuara mund të dërgojnë mendime.

VENDIM

Nr. 248, datë 30.4.2014

PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995, "Për nxitjen e punësimit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Zyra përkatëse e punësimit financon për punësimin e personave me aftësi të kufizuara:

a) Punëdhënësin, me një financim mujor në masën deri në 100 për qind të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, të pjesës së kontributit të punëdhënësit, me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të mos jetë më e shkurtër se një vit. Ky financim bëhet nga zyra e punësimit në degën e sigurimeve shoqërore sipas procedurave përkatëse;

b) Punëdhënësin, me një financim për të pajisur siç duhet vendin e punës/transport (përshtatja e arsyeshme) të personit me aftësi të kufizuara dhe për t'i siguruar atij/asaj një përgatitje thelbësore për punën deri në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë, por jo më shumë se 200 000 (dyqind mijë) lekë, nëse punëson më shumë se dy persona. Për këtë, punëdhënësit duhet të paraqesin një projekt për përshtatjen e arsyeshme;

c) Punëmarrësin, punëkërkuuesin e papunë, person me aftësi të kufizuara, sipas këtij programi, me një financim mujor në masën deri 100 për qind të nivelit të pagës minimale në shkallë vendi deri për 6 (gjashtë) muajt e parë të punësimit;

ç) Punëmarrësin, punëkërkuuesin e papunë, person me aftësi të kufizuara, me një financim mujor në masën deri në 50 për qind të nivelit të pagës minimale në shkallë vendi deri për 6 (gjashtë) muajt e dytë të punësimit.

2. Zyra përkatëse e punësimit financon për formimin në punë të personave me aftësi të kufizuara:

a) Punëdhënësin, deri në 70 për qind të tarifave me bazë koston e trajnimit;

b) Kursantin, punëkërkuuesin e papunë, të përfshirë sipas këtij programi, në masën deri në 50 për qind të pagës minimale në shkallë vendi;

c) Derdhjen e kontributit për sigurimin nga aksidentet në punë, në masën 0.5 për qind të pagës minimale, i cili derdhet në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, sipas procedurave përkatëse.

3. Pas përfundimit të kontratës së punës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, në rastin e vazhdimit të punësimit me kontratë, punëdhënësi ka të drejtë të riaplikojë për këtë program në vitin pasardhës, pas shprehjes së vullnetit të të dyja palëve për zgjatjen e kontratës, sipas kushteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Pas përfundimit të kontratës së punës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, në rastin e vazhdimit të punësimit me kontratë dhe me pagesë të plotë nga ana e punëdhënësit, në lidhje me pagesat e aftësisë së kufizuar zbatohet legjislacioni në fuqi.

5. Kohëzgjatja e programit të formimit në punë, sipas pikës 2 të këtij vendimi, është jo më shumë se 6 (gjashtë) muaj për të gjitha profesionet. Në përfundim të periudhës së formimit, punëdhënësit duhet të punësojnë jo më pak se 30 për qind të të trajnuarve, për një periudhë 6-mujore.

6. Pjesëmarrësit në formim, sipas pikës 2 të këtij vendimi, duhet të jenë persona të pakualifikuar profesionalisht.

7. Tarifat për kostot e formimit nëpërmjet punës vendosen nga komisioni i përcaktuar në vendimin nr. 47, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave, "Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë", të ndryshuar.

8. Punëkërkuuesit e papunë me aftësi të kufizuara, të përfshirë në program sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, nuk e humbasin pagesën që përfitojnë për shkak të aftësisë së kufizuar.

9. Një punëdhënës mund të aplikojë për të përfituar financimin e përcaktuar sipas pikës 1 ose sipas pikës 2 të këtij vendimi, por jo për të dyja pikat njëkohësisht.

10. Financimi sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, ndërpritet në rastin kur punëdhënësi, pas përfitimit të financimit, në zbatim të këtij vendimi, zgjidh pa shkaqe të arsyeshme kontratat e punës së punëmarrësve të tjerë të punësuar pranë tij.

11. Zyra përkatëse e punësimit bën njoftimin në Buletinin e Njoftimeve Publike, çdo vit, për fondin e vënë në dispozicion dhe kriteret e përfitimit nga ky program. Publikimi i programit bëhet, gjithashtu, me të gjitha mjetet e mundshme elektronike dhe joelektronike.

12. Punëdhënësi që aplikon për programin e punësimit nuk duhet të ketë shkelur në të kaluarën legjislacionin e punës dhe duhet të ketë derdhur,

rregullisht, tatimet e sigurimet e detyrueshme shoqërore, për aq kohë sa kryen veprimtarinë.

13. Për të përfituar nga ky program, punëdhënësi duhet të paraqesë pranë zyrës përkatëse të punësimit, ku ai zhvillon veprimtarinë, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Vendimin e gjykatës për regjistrimin si person juridik apo fizik ose vendimin e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit;

b) Numrin e identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT-in);

c) Vërtetimin për shlyerjen e kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, që lëshohen nga organi tatimor përkatës, për aq kohë sa ushtron veprimtarinë, për subjektet me kohëzgjatje aktiviteti më pak se një vit, dhe për një periudhë kohore njëvjeçare, nga çasti i aplikimit, për subjektet me kohëzgjatje aktiviteti prej më shumë se një viti;

ç) Numrin e llogarisë bankare;

d) Vërtetimin nga dega e tatim-taksave, ku personi juridik ushtron veprimtarinë, për shlyerjen e detyrimeve tatimore për aq kohë sa kryen veprimtarinë, por jo më gjatë se për një periudhë kohore njëvjeçare, nga çasti i aplikimit;

dh) Informacion për:

i) numrin e fuqisë punëtore;

ii) listën e të siguruarve;

iii) llojin e veprimtarisë që kryen;

iv) nivelin e pagës së dhënë për çdo person;

v) planbiznesin për shtimin e fuqisë punëtore;

vi) akte të inspektimit në punë, të kryera nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

14. Punëdhënësi mund të aplikojnë për programin në mënyrë elektronike apo pranë zyrave të punësimit.

15. Zyra përkatëse e punësimit ia paraqet këshillit vendor tripalësh, të ngritur pranë saj, projektet që kërkojnë të zbatohen aty ku ajo ushtron veprimtarinë, i cili, pasi shqyrton dhe vlerëson dobinë social-ekonomike të tyre, i miraton ato në parim.

16. Pas miratimit, në parim, të projekteve në këshillin vendor tripalësh, zyra përkatëse e punësimit ia dërgon, për miratim, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

17. Për zbatimin e pikës 15 të këtij vendimi, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit ngrihet komisioni i miratimit të projekteve, me jo më pak se 5 (pesë) persona. Mënyra e organizimit, vlerësimit të projekteve dhe e funksionimit të punës, si dhe përbërja e komisioneve përcaktohen në rregulloren e këshillit administrativ tripalësh të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

18. Komisioni i miratimit të projekteve në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit vendos miratimin ose jo të projektit, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune.

19. Për projektet e miratuara, zyra përkatëse e punësimit, në bashkëpunim me punëdhënësin, plotësojnë listën e punëkërkuësve të papunë, persona me aftësi të kufizuara, që do të përfshihen në program.

20. Ndërmjet zyrave përkatëse të punësimit dhe punëdhënësit nënshkruhet një kontratë, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet, në përputhje me programin, për secilën palë. Kontratat lidhen vetëm për vitin buxhetor për të cilin është miratuar projekti. Për vazhdimin e projektit, në vitin pasardhës do të lidhet një kontratë shtesë në përputhje me fondet e miratuar atë vit.

21. Punëdhënësi dhe punëkërkuësi si punëmarrës, nënshkruajnë një kontratë individuale pune, në të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve, sipas përcaktimeve të bëra në Kodin e Punës dhe në këtë vendim. Një kopje e kontratës së punës së çdo punëkërkuësi punëmarrës, depozitohet në zyrën përkatëse të punësimit, e cila ndjek zbatimin e kontratës deri në përfundim të projektit.

22. Në rastet kur punëkërkuësi si punëmarrës, pjesëmarrës në këtë program, largohet përpara afatit të përcaktuar në kontratë, për shkaqe të arsyeshme, zëvendësimi bëhet nga zyra përkatëse e punësimit, pas njoftimit nga punëdhënësi për shkaqet e zgjidhjes së kontratës.

23. Nëse punëdhënësi në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të arsyeshme bën zgjidhjen e kontratës së punës me punëkërkuësin e punësuar, është i detyruar ta kthejë të gjithë financimin e marrë për punëkërkuësin e punësuar, që nga data e parë e dhënies së tij, së bashku me interesat, të llogaritura sipas normës bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë.

24. Kontratat tip, sipas përcaktimeve të dhëna në pikat 20 e 21 të këtij vendimi, hartohen nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga zyrat përkatëse të punësimit.

25. Shërbimi Kombëtar i Punësimit analizon efektshmërinë e programit dhe përgatit raporte vjetore, brenda datës 31 mars të viti pasardhës, të cilat ia paraqet Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Drejtorisë së Ndhmës Shtetërore, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

26. Shërbimi Kombëtar i Punësimit ruan të dhënat për skemën deri në 10 (dhjetë) vjet, pas dhënies së fundit të ndihmës individuale.

27. Programi vlerësohet, në vitin pasardhës, nga ekspertë ose organizata të pavarura që kanë përvojë në këtë fushë dhe njohuri për tregun e punës.

28. Kostoja dhe vlerësimi i këtij programi përballohen nga fondet vjetore të buxhetit të shtetit, zëri "Nxitja e punësimit", miratuar për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

29. Skema të fillojë të zbatohet me hyrjen në fuqi të këtij vendimi dhe kohëzgjatja e saj të jetë 5 (pesë) vjet.

30. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për nxjerrjen e udhëzimeve për zbatimin dhe mbikëqyrjen e programit, dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit për zbatimin e programit nëpërmjet zyrave të punësimit.

31. Vendimi nr. 353, datë 24.3.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuësve të papunë të rinj”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 249, datë 30.4.2014

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 396,
DATË 31.3.2005, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR MIRATIMIN E KUFLJVE DHE
RREGULLORES SË ADMINISTRIMIT TË
PARQEVE ARKEOLOGJIKE TË SHKODRËS,
LEZHËS, APOLONISË, BYLISIT, AMANTIAS,
ORIKUMIT, ANTIGONESË, FINIQIT DHE
BUTRINTIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 7 të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe të pikës 2 të nenit 29 të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore” të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në rregulloren e administrimit të parqeve arkeologjike, miratuar me vendimin nr. 396, datë 31.3.2005, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 e kreut I, ndryshohet si më poshtë vijon:
“3. Strukturat përgjegjëse të administrimit të parqeve arkeologjike janë si më poshtë vijon:

- Struktura përgjegjëse për administrimin e Parkut Arkeologjik Shkodër-Lezhë, sipas kësaj rregulloreje është Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Shkodër;

- Struktura përgjegjëse për administrimin e Parkut Arkeologjik Antigone, sipas kësaj rregulloreje është Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Gjirokastrë;

- Struktura përgjegjëse për administrimin e Parkut Arkeologjik Amantia-Orikum-Finiq, sipas kësaj rregulloreje është Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Vlorë;

- Struktura përgjegjëse për Administrimin e Parkut Arkeologjik, Apoloni, është Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik, Apoloni.

- Struktura përgjegjëse për administrimin e Parkut Arkeologjik, Bylis, është Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik, Bylis.”.

2. Në kreun II bëhen këto ndryshime:

a) Pika 5 ndryshohet si më poshtë vijon:

“5. Krijohet Bordi Kombëtar i Parqeve Arkeologjike (BKPA), organ vendimmarrës, i cili mbikëqyr veprimtarinë e ZAKPA-ve dhe strukturave përkatëse pranë drejtorive rajonale të kulturës kombëtare. BKPA-ja kryesohet nga ministri i Kulturës dhe përbëhet nga përfaqësues të:

- Ministrisë së Mjedisit;

- Ministrisë për Çështjet Vendore;

- Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit;

- Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit Strategjik për Trashëgiminë dhe Diversitetin Kulturor;

- Institutit të Monumenteve të Kulturës;

- Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.

Drejtorët e drejtorive rajonale të kulturës kombëtare të Gjirokastrës, Shkodrës, Vlorës dhe drejtori i ZAPA-së Apoloni-Bylis marrin pjesë në mbledhjet e Bordit, pa të drejtë vote.”.

b) Pika 7 shfuqizohet.

3. Në kreun III bëhen këto ndryshime:

a) Pika 11 shfuqizohet.

b) Pikat 13 dhe 14 ndryshohen si më poshtë vijon:

“13. ZAKPA-të janë struktura buxhetore në varësi të ministrit të Kulturës. Struktura dhe organika e tyre miratohet me urdhër të Kryeministrit.

14. Drejtori i ZAKPA-së emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga detyra nga ministri i Kulturës.”.

4. Ngarkohen zyrat e administrimit të Parkut Arkeologjik Shkodër-Lezhë, të Parkut Arkeologjik Amantia-Orikum-Finiq dhe të Parkut Arkeologjik Antigone të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin ligjor pranë drejtorive rajonale të kulturës kombëtare Shkodër, Vlorë dhe Gjirokastrë.

5. Dorëzimi i dokumentacionit të bëhet brenda 15 ditëve nga data e miratimit të strukturës dhe të organikës për secilën drejtori rajonale të kulturës kombëtare përgjegjëse.

6. Fondi i buxhetit i parashikuar për strukturat e parqeve që transferohen pranë drejtorive rajonale të kulturës kombëtare do t'i rialokohet institucionit të cilit i transferohen të drejtat.

7. Në të gjithë përmbajtjen e vendimit, emërtimet “Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve” dhe “ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve” zëvendësohen përkatësisht me “Ministria e Kulturës” dhe “ministri i Kulturës”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 252, datë 30.4.2014****PËR FUNKSIONIMIN, TË DREJTAT DHE
DETYRAT E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË
TITUJVE AKADEMIKË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 67 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë (KVTA) funksionon si organ kolegjal vendimmarrës, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

2. Ky komision, në ushtrim të funksioneve dhe të përgjegjësive të përcaktuara në ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, kryen dhe ka këto detyra e të drejta:

a) Vlerëson dhe merr vendim për propozimet e institucioneve të arsimit të lartë për dhënien e titullit akademik "Profesor". Propozimet dhe vendimet për dhënien e titujve regjistrohen nga sekretariati i KVTA-së në regjistrin e krijuar për këtë qëllim. Procedura e shqyrtimit dhe formati i regjistrimit të titujve akademikë përcaktohen me udhëzim të ministrit të Arsimit dhe Sportit.

b) Kryen njohjen zyrtare në Republikën e Shqipërisë të gradave ose titujve shkencorë, të lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë, sipas procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit të Arsimit dhe Sportit. Kërkesat dhe vendimet për njohjen e titullit regjistrohen nga sekretariati i KVTA-së në regjistrin e krijuar për këtë qëllim. Formatu i regjistrimit të të dhënave përcaktohet me udhëzim të ministrit të Arsimit dhe Sportit.

c) U bën rekomandime institucioneve të arsimit të lartë për organizimin e studimeve të doktoratës dhe promovimin për titujt akademikë.

ç) Vlerëson, me kërkesë të ministrit të Arsimit dhe Sportit, zbatimin e kriterëve dhe të procedurave për kualifikimin shkencor nga institucionet e arsimit të lartë dhe, kur vëren shkelje të kuadrit ligjor dhe nënligjor, propozon masat përkatëse.

d) Gëzon të drejtën të dërgojë përfaqësuesit e vet për të mbikëqyrur procedurat për mbrojtjen e doktoratave, si dhe për shqyrtimin e titujve akademikë, të cilat zhvillohen nga institucionet e arsimit të lartë në mbledhjet (seancat) e hapura.

KVTA-së mund t'i ngarkohen edhe detyra të tjera për kualifikimin shkencor, në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

3. KVTA-ja merr vendim me shumicën e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

4. Komisioni mblidhet me njoftim të kryetarit, sipas rendit të ditës, të përcaktuar prej tij.

5. Mbledhjet zhvillohen sipas rregullores, të miratuara nga vetë KVTA-ja.

6. Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë (KVTA) përbëhet nga 15 anëtarë, sipas aneksit 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Pagesa e kryetarit dhe e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë të jetë, përkatësisht, 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë për mbledhje, për kryetarin, dhe nga 13 000 (trembëdhjetë mijë) lekë për mbledhje, për anëtarët. Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë mblidhet jo më shumë se 9 (nëntë) herë në vit.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

9. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 633, datë 23.5.2008, "Për funksionimin, të drejtat dhe detyrat e Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë" dhe nr. 599, datë 31.8.2006, "Për përbërjen e Komisionit të Kualifikimit Shkencor", shfuqizohen.

10. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama****ANEKSI 1**

Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë përbëhet nga 15 anëtarë, si më poshtë:

- | | |
|--|----------|
| 1. Ministri i Arsimit dhe Sportit | kryetar; |
| 2. Prof. Gudar Beqiraj, përfaqësues nga Akademia e Shkencave | anëtar; |
| 3. Prof. Dhori Kule, përfaqësues nga Konferenca e Rektorëve | anëtar; |
| 4. Prof. Petrit Malaj | anëtar; |
| 5. Prof. Jorgaq Kaçani | anëtar; |
| 6. Prof. Luljeta Minxhozi | anëtar; |
| 7. Prof. Margarita Qirko | anëtar; |
| 8. Prof. Fatos Harizaj | anëtar; |
| 9. Prof. Anyla Bulo | anëtar; |
| 10. Prof. Klodeta Dibra | anëtar; |
| 11. Prof. Sulo Hadëri | anëtar; |
| 12. Prof. Shezai Rrokaj | anëtar; |
| 13. Prof. Valentina Duka | anëtar; |
| 14. Prof. Aurela Anastasi | anëtar; |
| 15. Prof. Fatmir Hoxha | anëtar. |

UDHËZIM
Nr. 13, datë 6.5.2014

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 32,
DATË 31.12.2013, “PËR TATIMIN E THJESHTUAR
MBI FITIMIN E BIZNESIT TË VOGËL”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, ministri i Financave

UDHËZON:

1. Në pikën 10 “Administrimi i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin”, në fund të paragrafit të parë shtohet fjalia me përmbajtjen e mëposhtme:

“Drejtoria Rajonale e Tatimeve, në funksionin e arkëtimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për llogari të bashkive/komunave, konsiderohet agjent shërbimi i këtyre të fundit. Si e tillë, DRT-ja regjistron shumat e arkëtuara në kredi të llogarisë 4481100 “Agjent shërbimesh të vitit në vazhdim” me kartela analitike për çdo bashki dhe komunë.”.

2. Në pikën 11 “Transferimi i të ardhurave në llogaritë e njëjësive të qeverisjes vendore”, në germen “c” shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Për të bërë transferimin, paraprakisht, kryhet procesi i rakordimit midis drejtorive rajonale tatimore me bashkitë dhe komunat, lidhur me shumat e arkëtuara sipas subjekteve tatimpaguese. Në aktrakordimin e

hartuar në tri kopje, sipas formatit bashkëlidhur këtij udhëzimi, paraqitet e ndarë shuma totale e arkëtuuar për bashkinë/komunën, si dhe shuma e komisionit në masën 1% e të ardhurave të arkëtuara.

Drejtoritë rajonale tatimore, në bazë të aktrakordimit dhe listës së tatimpaguesve të konfirmuar nga të dyja palët, kryen transfertën nga llogaria e drejtorive rajonale “Tatime me deklarim”, në llogarinë bankare të të ardhurave të degës së thesarit në rrethin përkatës, në emër të bashkisë apo komunës.

Drejtoritë rajonale tatimore dërgojnë pranë degës së thesarit të rrethit përkatës një kopje të aktrakordimeve të mbajtura me secilën bashki/komunë. Në bazë të aktrakordimit përmbledhës të konfirmuar nga nëpunësi zbatues dhe autorizues i të dyja palëve, dega e thesarit të rrethit përkatës, për shumën 1% që përfiton administrata tatimore si agjent tatimor, bën rritjen e autorizuar në llogarinë e shpenzimeve 604 “Transferta në institucionet nacionale” në emër të bashkisë apo komunës përkatëse, si dhe kryen transferimin e brendshëm në sistemin financiar informatik nga bashkia/komuna në drejtorinë rajonale tatimore, duke kredituar llogarinë 7200106 “Grant nga transferimet e institucioneve lokale (bashki e komuna) tek institucionet nacionale.”.

Ky udhëzim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani

AKT-RAKORDIMI

I mbajtur në datën _____, midis Drejtorisë Rajonale Tatimore _____ dhe komunës/bashkisë _____, lidhur me totalin e shumës së arkëtuuar, nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, në llogarinë përkatëse të DRT-së, për periudhën nga data _____ deri në datën _____

Lloji i taksës	Emri i komunës/bashkisë	Llogaria kontabile (ku kanë kaluar arkëtimet)	Muaji në të cilin janë bërë arkëtimet	Shuma e arkëtuar gjithsej (në lekë)	Shuma e të ardhurave për komunën/bashkinë (99% e totalit)	Shuma e të ardhurave që i takon DRT-së (1% e totalit)
1	2	3	4	5	6=5 x 99%	7 = 5 x 1%
Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël		4481100	01 deri 00/00/2014			

Shënim. Akt-rakordimi përpilohet në tri kopje. Akt-rakordimit i bashkëngjitet lista e tatimpaguesve të konfirmuar nga të dyja palët. Shuma totale e tatimit të arkëtuuar (shuma në kolonën 5) duhet të jetë e barabartë me shumën totale të listës (sipas udhëzimit nr. 32, datë 31.12.2013) bashkëngjitur akt-rakordimit.

Për komunën/bashkinë _____
Nëpunësi zbatues (emër, mbiemër)
Nëpunësi autorizues (emër, mbiemër)

Për Drejtorinë Rajonale Tatimore _____
Nëpunësi zbatues (emër, mbiemër)
Nëpunësi autorizues (emër, mbiemër)

KËRKESE

Shtetasja Ruzhdije Kasapi, e bija e Halimit dhe e Nezires, lindur dhe banuese në Lushnjë, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë shpalljen të vdekur të djalit të saj, shtetasit Marjus Kasapi, i datëlindjes 25.11.1987.

KËRKUESI
Ruzhdije Kasapi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 20 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006